

V E N D I M
Nr.374, datë 12.8.1999

**PËR MËNYRËN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE NGA PRIVTIZIMI I SHOQËRISË
ANONIME "ALBANIAN MOBILE COMMUNICATION" (AMC)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 "Për privatizimin e shoqërisë anonime "Albanian Mobile Communication" (AMC)", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Të ardhurat nga privatizimi i shoqërisë anonime "Albanian Mobile Communication" (AMC), në ndryshim nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore", të përdoren si më poshtë:

a) 10 për qind të përdoren nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e shitjes së aksioneve dhe për pagimin e "tarifës së suksesit" kompanisë këshilluese, sipas kontratës së lidhur me të.

b) Pjesa tjetër e të ardhurave të derdhet në Buxhetin e Shtetit.

2. Struktura e këtyre pagesave të parashikohet në ligjin për buxhetin e shtetit për vitin 2000.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të paraqesë, pas përfundimit të procesit të shitjes, raportin financiar për përdorimin e vlerave të mësipërme.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko